

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Blokokohen specat dhe açuget shqiptare, Itali dhe Kroaci zbulojnë nivele të larta ndotësish - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/blokokohen-specat-dhe-acuget-shqiptare-itali-dhe-kroaci-zbulojne-nivele-te-larta-ndotesish/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 20:12:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 19:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ce3edd2f92e2b241d587f1771d5d55caa874c4b881abd74b1478efec1a6bfc3f
TEKSTI	c220a8a8108d6b54442af6940c2852b1130acb8aa190692dbc224e8bc0ed5e94
PAMJA	d7c3bf03255c931f8edb9feee30ea6f4dfc05b6058cf89ef3fb6542b90f75208

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a9f124170f3beba0cfbeb882604283cc23630edd5d9e8e0a16855c7e5a69b9c8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	de40688aef4c4ba129d7a84fd77d2b1b27a16260a8d1d580a5a1a060453e9f69
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a9f124170f3beba0cfbeb882604283cc23630edd5d9e8e0a16855c7e5a69b9c8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Blllokohen specat dhe açuget shqiptare, Itali dhe Kroaci zbulojnë nivele të larta ndotësish

AKTUALITET

Demo

Blllokohen specat dhe açuget shqiptare, Itali dhe Kroaci zbulojnë nivele të larta ndotësish

SEPTEMBER 24, 2026



Problemet me sigurinë ushqimore prekin sërish produktet shqiptare të eksportuara në vendet e Bashkimit Evropian. Këtë herë bëhet fjalë për açuge të bllokua në Itali për shkak të niveleve të larta të histaminës dhe specat të kuq të ndaluar në Kroaci për shkak të pranisë së një insekticidi mbi kufijtë e lejuar.

Në Itali është bllokuar një sasi açugesh të eksportuara nga Shqipëria, pasi analizat kanë evidentuar prani të lartë të histaminës, një substancë që mund të shkaktojë probleme serioze shëndetësore në rast të konsumit në nivele të larta.

Sipas të dhënave të publikuara, produkti ishte eksportuar nga kompania shqiptare "Poseidoni" dhe është zbuluar gjatë kontrolleve të kryera nga autoritetet italiane të sigurisë ushqimore në një supermarket. Analizat kanë treguar një përqendrim prej 800 mg/kg histaminë, ndërsa kufiri maksimal i lejuar është 400 mg/kg.

Pas konstatimit të problemit dhe publikimit të rezultateve të analizave, produkti është tërhequr nga tregu italian.

Ndërkohë, edhe autoritetet kroate kanë bllokuar një tjetër ngarkesë me produkte bujqësore shqiptare. Bëhet fjalë për 3427 kilogramë specat të kuq, të cilët kanë rezultuar me prani të lartë të insekticidit Flonicamid.

Sipas të dhënave të raportuara, prodhimi është kultivuar në fshatin Mollas të Elbasanit. Flonicamidi përdoret në bujqësi për luftimin e disa dëmtuesve të bimëve, përfshirë mizën e bardhë dhe morrat e bimëve.

Analizat laboratorike kanë evidentuar një prani prej 0.8 mg/kg të kësaj substance në specat e kuq, ndërsa për këtë produkt prania e saj duhet të jetë zero, sipas të dhënave të referuara në njoftimin e sistemit të kontrollit.

Edhe pse Flonicamidi është një preparat i lejuar për mbrojtjen e bimëve, prania e mbetjeve të tij në produkt mund të lidhet me mosrespektimin e periudhës së karencës, pra kohës që duhet të kalojë nga përdorimi i pesticidit deri në vjeljen e produktit.

Kjo është ngarkesa e katërt me specat të bllokua nga Kroacia gjatë këtij muaji, sipas të dhënave të raportuara.

Rastet e përsëritura të bllokimit të produkteve shqiptare për shkak të problemeve të sigurisë ushqimore ngrënë pikëpyetje për respektimin e standardeve gjatë prodhimit dhe kontrollin e produkteve para eksportit.

Ndërkohë, problematikat e tilla mund të kenë pasoja edhe për fermerët e tjerë shqiptarë, pasi rastet

Postimet e reja

Brad Pitt shkëlqen në tapetin e kuq me...

SEPTEMBER 24, 2026

Blllokohen specat dhe açuget shqiptare, Itali d...

SEPTEMBER 24, 2026

Të huajt blejnë më pak prona në Shqipëri, por...

SEPTEMBER 24, 2026

U arrestua në Rusi, zbulohet portreti i...

SEPTEMBER 24, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç "Delvina Gas" ai...

ALERT në Slloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits"
të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

e evidentuara në tregjet europiane ndikojnë në perceptimin dhe kërkesën për produktet shqiptare, duke krijuar presion edhe mbi çmimet e prodhimeve bujqësore.

ndotësish nivele shqiptare

SHARE.

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.